

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-221/15

**Prishtinë,
30 maj 2018**

Në çështjen juridike të

V. J.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Beshir Islami kryetar i kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Ragip Namani, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/260/2014, të datës 21 tetor 2014 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA13243), pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 30 Maj 2018, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e paraqitur nga V. J. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014 të datës 21 tetor 2014, sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP me numër KPA13243.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/260/2014 i datës 21 tetor 2014, sa i përket kërkesës të regjistruar në AKP me numër KPA13243, vërtetohet.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 1 korrik 2008, V. J. (në tekstin e mëtejme: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) duke kërkuar vërtetimin e së drejtës pronësore mbi ngastrën kadastrale numër 958, livadh i klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 00.65.40 ha, e cila gjendet në vendin e quajtur “ Broška kod Jokića ”, zona kadastrale “Gushice” e regjistruar në fletën poseduese nr. 240, Konuna e Vitisë (tani e tutje: prona e kërkuar).
2. Në mbështetje të kërkesës, pala ankuese i ka dorëzuar AKP-së këto dokumente:
 - Fletën poseduese nr. 240, të lëshuar nga Drejtoria e Gjeodezisë e Komunës së Vitisë më 24 nëntor 1986, në të cilën prona e kërkuar figuron e regjistruar në emër të V.P.,
 - Aktgjykimin nr. 345/88 të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Gjilan më 25 janar 1989, me anë të së cilit është aprovuar padia e L. dhe V. J., kështu të paditurit: Ndërmarrja “Agromorava”, A. S., M. J.B. J., D. P., L.S, F. E., A. . dhe G. S. janë obliguar që t’ia njohin paditësve(V. dhe L. J.) të drejtën pronësore mbi pronën e kërkuar.
 - Vendimin nr. 1105/89 të lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës më 15 maj 1990 , me anë të së cilit gjykata e konfirmon se V. dhe L. J. e kanë të drejtën pronësore mbi pronën e kërkuar nr. 958, livadh i klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 00.65.40 ha, i cili gjendet në vendin e quajtur “ Broška kod Jokića ” dhe e regjistruar në fletën poseduese nr. 240. pozitive
 - Certifikatën e vdekjes nr. 203-42/04-35 të lëshuar më 27 shkurt 2004 nga Zyra e Regjistrimit Civil në Kragujevc, në të cilën figuron se L. J. ka vdekur më 22 shkurt 2004,
 - Kërkesa e paraqitur pranë Agjencisë Kadastrale të Kosovës nga L. dhe V. J. për implementimin e ndryshimeve në kadastër,
 - Fletën poseduese nr. 240 të lëshuar nga Zyra Kadastrale e Vitisë më 7 qershor 2007, në të cilën prona e kërkuar figuron e regjistruar në emër të V. P.
3. Më 23 shkurt 2010, AKP-ja e ka njoftuar kërkesën dhe ka gjetur se prona e kërkuar nuk është e zënë. Asnjë palë e interesuar nuk ka paraqitur kërkesë brenda afatit prej 30 ditësh, prandaj, kërkesa është konsideruar si jokontestuese.

4. Vendimi nr. 1105/89 i lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës më 15 maj 1990, është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive e AKP-së, ndërsa Departamenti i Kadastrit dhe Gjeodezisë i Komunës së Vitisë ka konfirmuar se prona e kërkuar është gjetur në emër të palës së tretë. Në raportin e verifikimit janë bashkangjitur provat në vijim:
 - Historiku kronologjik i ngastrës kadastrale 958 i lëshuar më 7 tetor 2014, nga Drejtoria e Kadastrit dhe Gjeodezisë e Komunës së Vitisë përmes të cilit Drejtoria e Kadastrit dhe Gjeodezisë e Komunës së Vitisë konfirmon se prona e kërkuar figuron në emër të H. I. që nga viti 1982 dhe se institucioni i lartpërmendur nuk i posedon ndryshimet të cilat mund të kenë ndodhur gjatë periudhës së viteve 1983-1999.
 - Certifikatën mbi të drejtat e paluajtshme nr. 958-0 të lëshuar nga Komuna e Vitisë më 7 tetor 2014, në të cilën prona e kërkuar figuron në emër të H. I..
5. Nga provat në shkresat e lëndës rezulton se pala ankuese është kontaktuar nga AKP-ja përmes telefonit dhe ai ka konfirmuar se në vitin 1967 ai e kishte blerë pronën e kërkuar nga V. P., por ai ka qenë i pakujdesshëm për t'i bërë ndryshimet në kadastër menjëherë pas blerjes së pronës së kërkuar dhe pas një kohe kërkesa e tij për transferimin e pronës në emër të tij ishte refuzuar nga kadastrit, sepse V. P. dhe djali i tij D. kishin vdekur. Lidhur me gjetjet e Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së, pala ankuese pretendon se prona e kërkuar paraqitet në emër të palës së tretë gabimisht. (Faqet 278, 286, 287 të shkresave të lëndës).
6. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës me anë të vendimit të tij KPCC/D/A/260/2014 të datës 21 tetor 2014, ka vendosur ta refuzojë kërkesën për arsye se pala ankuese nuk e ka dëshmuar se kërkesa e saj përfshinë rrethanat të lidhen drejtpërsëdrejti ose që rezultojnë nga konflikti i vitit 1998-1999.
7. Vendimi i është dorëzuar palës ankuese më 23 shkurt 2015. Ai ka paraqitur ankesë më 23 mars 2015.

Pretendimet e palës ankuese

8. Pala ankuese pretendon se KKKPK-ja nuk i ka vërtetuar faktet materiale në mënyrë të plotë
9. Në ankesë, pala ankuese ka bërë një prezantim të detajuar të dokumenteve të cilat i ka dorëzuar për ta vërtetuar të drejtën e tij pronësore duke iu referuar aktgjykimit nr. 345/88 të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Gjilan më 25 janar 1989 dhe vendimit nr. 1105/89, të lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës më 15 maj 1990.
10. Pala ankuese përsëri ka theksuar se pronën e kërkuar e kishte blerë nga V.P., dhe djali i tij D. P. asnjëherë nuk e kishte mohuar këtë fakt.
11. Në fund të ankesës së tij, pala ankuese ka insistuar se kishte bërë një kërkesë për ndërrimin e pronarit të pronës pranë kadastrit kompetent dhe se kishte marrë përgjigje se kushtet për regjistrimin e pronës së kërkuar në emër të tij ishin përmbushur.

Arsyetimi ligjor :

Pranueshmëria e ankesës

12. Gjykata Supreme e ka shqyrtuar vendimin e kundërshtuar në përputhje me dispozitat e nenit 194 të Ligjit për procedurën kontestimore nr. 03/L-006 (tani e tutje: LPK), dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë ka gjetur se:
Ankesa është e pranueshme sepse është paraqitur brenda afatit ligjor në përputhje me Ligjin nr. 03/L-079, i cili përcakton se pala mund të paraqes ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e njoftimit në lidhje me vendimin.

Meritat e ankesës

13. Sidoqoftë, ankesa është e pabazuar.
14. KKKPK-ja vendimin e tij e ka bazuar në faktin se pala ankuese nuk e ka dëshmuar se kërkesa e tij përfshinë rrethanat të lidhen drejtpërsëdrejti ose që rezultojnë nga konflikti i vitit 1998-1999.
15. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër të Komisionit për ri-posedimin e pronës së kërkuar nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që duhet ta dëshmojë të drejtën e tij pronësore mbi pronën e paluajtshme private, por gjithashtu duhet të dëshmojë që ai ose ajo tani nuk është në gjendje ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërsëdrejti me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
16. Megjithatë, çështja për t'u shqyrtuar në këtë lëndë është nëse pala ankuese ka paraqitur prova për ta vërtetuar të drejtën pronësore mbi pronën e kërkuar; prandaj, Gjykata Supreme do ta jap një përmbledhje të shkurtër në lidhje me çështjen në fjalë.
17. Vetë pala ankuese ka deklaruar se prona është blerë nga V. P, por që nuk i ka bërë ndryshimet në kadastrë. Për më tepër, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së ka bërë verifikim negativ të certifikatës mbi të drejtat e paluajtshme. KKKPK-ja sipas detyrës zyrtare nuk ka qenë në gjendje të marrë asnjë provë në mbështetje të pretendimit të palës ankuese.
18. Sipas nenit 20 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (GZ RSFJ, Nr. 6/1980), i zbatueshëm në kohën e nxjerrjes së aktgjyqimit, e drejta e pronës mund të fitohet me ligj, në bazë të marrëdhënies ligjore ose trashëgimisë ... në bazë të marrëdhënies juridike (që është aktgjykimi në këtë rast) e drejta e pronësisë mbi pronën e paluajtshme fitohet me regjistrim në "regjistrin kadastral " ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme që është të paraparë me ligj, nenin 33 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore (GZ RSFJ, Nr. 6/1980).
19. Certifikata mbi të drejtat e paluajtshme fillimisht ka gjetur pronën e regjistruar në emër të V. P. dhe pastaj në emër të palës së tretë, kjo do të thotë se aktgjykimi nr. 345/88 i lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Gjiilan më 25 janar 1989 dhe vendimi nr. 1105/89 i lëshuar nga Gjykata Supreme e Kosovës më 15 maj 1990, nuk janë ekzekutuar asnjëherë.
20. Pala ankuese nuk e ka fituar të drejtën pronësore pasi që kushtet nga neni 33 i Ligjit mbi marrëdhëniet themelore pronësore (RSFJ, nr. 6/1980) sipas të gjeturave, nuk janë përmbushur.
21. Pretendimi i palës ankuese se kadastrë kompetent ka lejuar regjistrimin e pronës së kërkuar në emër të tij ka të bëjë me një kërkesë tjetër.

22. Duke e pasur parasysh këtë, Gjykata Supreme gjen se vendimi i KKKPK-së duhet të vërtetohet.
23. Në bazë asaj që u tha më lart, në përputhje me nenin 13.3 nën (a) të Ligjit nr. 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, kryetar i kolegjit

Ragip Namani, gjyqtar

Timo Eljas Torkko, referente e EULEX-it